

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Si po e ndan Serbinë funerali për Ratko Mladiçin
ADRESA	https://www.gazetatema.net/rajoni/si-po-e-ndan-serbine-funerali-per-ratko-mladicin-i584159
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	redirected

KOHA


KAPUR NGA NE	5 shtator 2026, 16:12:21 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	5 shtator 2026, 17:25:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f4102e3fd4f6a4fa3ea7b6ebd30fa495f3028e8327d6aa254da58bd31b485bb2
TEKSTI	55ee4881f31f235df230014ccca5106fe8af7e2d9ceb4771a8dc5c0346fd6f05
PAMJA	40200afbe386b4d85c1b59b8118dee38cea6fed4e1dd260bf82eb032d54e00a3

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b92b7f8eb18e0ac8c0abfb15603e548fe912e918be3512911b2dedb0c7427884
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	82597d84b51b00d12dc8da6bd19ef563dde476bcf2b8ac3fbaec8c83c315f326
ANKORUAR	Polygon PoS · bllok 46991200
TRANSAKSIONI	0x4a6949f734bb917e86ef48a394a39f5e560c6ca7cb50992564901c0d93c74ab3
IPFS	QmcQ2vpHEy67KT56kkLrEBokuUFGqg7MP3SJ63znFCszpz



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b92b7f8eb18e0ac8c0abfb15603e548fe912e918be3512911b2dedb0c7427884>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

 English

Built and Monetized by 

[Kontakt](#)



 English



ie [Barcelona zgjedh pese kapitenet per sezonin e ri, surpriza eshte Lamine Yamal](#) [Muhi ve ne veprim "Planin B" ne SHBA](#) [Lamtumire Prof. Dr. Selam Meço, kolosi i gjeologjise fundit](#)

Si po e ndan Serbinë funerali për Ratko Mladiçin



5 Shtator 2026, 19:25Rajoni TEMA



Ndërsa qeveria serbe ia ka lënë familjes vendimin për organizimin e funeralit të Ratko Mladiçit, presioni ndërkombëtar ndaj Serbisë po rritet. Si e shohin serbët këtë çështje?

Trupi i ish-komandantit të Ushtrisë së Serbëve të Bosnjës, Ratko Mladiç, i cili u nda nga jeta javën e kaluar në Hagë, ku po vuante një dënim me burgim të përjetshëm për gjenocid dhe krime të tjera lufte në Bosnje dhe Hercegovinë, është kthyer në Serbi.

I mbështjellë me flamurin serb, arkivoli i Mladiçit u transportua nga anëtarët e Forcave të Armatosura Serbe nga avioni në një automjet që e çoi trupin e tij në Akademinë Ushtarake-Mjekësore për autopsi.

Disa grupe qytetarësh u mbledhën përgjatë rrugës nga aeroporti deri në spital. Duke qëndruar në mbikalime, ata përshëndetën autokolonën që transportonte trupin e Mladiçit, duke mbajtur pankarta me mbishkrimet "Faleminderit, Gjeneral" dhe "Heronjtë nuk vdesin kurrë".

Tabloidët proqeveritarë raportuan minutë pas minute për ngjarjen, duke iu referuar Mladiçit si një "gjeneral serb" dhe duke pretenduar se ai ishte "vranë në Hagë".

Një funeral me nderime të plota shtetërore?

Ratko Mladiç u dënua në vitin 2017 me burgim të përjetshëm nga Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë në Hagë për gjenocidin në Srebrenicë, ku u vranë më shumë se 8.000 burra dhe djem myslimanë, për rrethimin shumëvjeçar të Sarajevës gjatë Luftës së Bosnjës (1992-1995), si dhe për krime të tjera lufte, përfshirë ngritjen e kampeve të ndalimit për civilë joserbë dhe robër lufte.

Mediat e Beogradit raportojnë se Mladiç do të varroset të hënën (07.09.2026) në Beograd. Ministri i Drejtësisë, Nenad Vujić, kishte njoftuar më parë se funerali do të zhvillohej me nderimet më të larta shtetërore.

Megjithatë, presidenti serb Aleksandar Vučić tha se vendimi do t'i lihet familjes.

Agjencitë e sigurisë vlerësojnë se dhjetëra mijëra njerëz mund të marrin pjesë në funeral.

"Ne do të jemi aty për të ofruar çdo lloj mbështetjeje logjistike dhe transporti, si dhe për të ruajtur rendin dhe sigurinë publike", tha presidenti, duke shtuar: "Është shumë e vështirë të sigurohet dhe garantohet siguria e të gjithëve."

Glorifikimi që ka vazhduar për dekada

Për Jasmina Lazović, drejtoreshë ekzekutive e Qendrës për të Drejtën Humanitare në Beograd, e cila prej dekadash merret me drejtësinë dhe përballjen me të kaluarën, asgjë nga kjo nuk është befasi.

Ajo thekson glorifikimin afatgjatë të Ratko Mladiçit në Serbi dhe trashëgiminë e tij. "Nuk ka asnjë qytet të vogël në Serbi pa të paktën një mural që vlerëson Ratko Mladiçin. Narrativa se ai u dënua padrejtësisht ekziston prej vitesh", tha ajo për DW. "Tani ka lindur edhe narrativa se ai u vra, megjithëse ai vdiq në moshën 85-vjeçare pasi kishte pësuar disa goditje në tru."

Sipas Lazovićit, këto narrativa përputhen me paraqitjen që udhëheqja shtetërore i bën Serbisë si një vend që ka zhvilluar vetëm luftëra mbrojtëse dhe nuk lënë hapësirë të mjaftueshme për diskutimin e pasojave të këtyre luftërave dhe viktimave që ato lanë pas, as në media dhe as në sistemin arsimor e institucionet.

"Dhe ka qindra mijëra viktimë në Kroaci, Bosnje dhe Hercegovinë dhe Kosovë. Mbi të gjitha, këto ishin krime të kryera kundër civilëve, krime që i lanë vendet e rajonit, veçanërisht Bosnjën dhe Hercegovinën, me një strukturë etnike krejtësisht të transformuar", tha ajo.

Lazović shton se lista e viktimave përfshin gjithashtu të mbijetuarit e përdhunimeve dhe torturave, si dhe ata që u dëbuan me forcë. "Lista është e gjatë dhe njohuritë tona janë të kufizuara", shtoi ajo.

Një gjeneral pa gradë

Njoftimi se Mladiç mund të varroset me nderimet më të larta shtetërore shkaktoi reagime të menjëhershme nga komuniteti ndërkombëtar. "Glorifikimi i kriminelëve të luftës është në kundërshtim me vlerat evropiane. Nuk ka vend për këtë as në shtetet anëtare të BE-së dhe as në vendet kandidate. Shpresoj që qeveria në Beograd ta ketë të qartë këtë", tha Komisionerja Evropiane për Zgjerimin, Marta Kos.

Aleksandar Vučiću përgjigj duke akuzuar Perëndimin dhe Tribunalin e Hagës se kanë fajësuar vetëm serbët për krimet e luftës dhe se nuk kanë sjellë drejtësi për viktimat serbe. Megjithatë, ai zyrtarisht ia ka lënë familjes së Mladiçit vendimin nëse gjenerali i ndjerë do të marrë nderime shtetërore.

Jasmina Lazović beson se Vučićdo të ndjekë edhe një herë një qasje pragmatike dhe se vendimi përfundimtar do të varet nga vlerësimi se çfarë i sjell më shumë përfitim politik pushtetit dhe çfarë mund të shkaktojë më shumë dëm.

Ajo thekson gjithashtu se çështja nuk është vetëm politike, por edhe juridike. "Ajo që po anashkalohet këtu është fakti se Ratko Mladiç ishte vërtet gjeneral, por ai u dënua me burgim të përjetshëm. Sipas Ligjit për Forcat e Armatosura të Serbisë, kushdo që dënohet me më shumë se një vit burg për një vepër penale humbet gradën e tij dhe, rrjedhimisht, të gjitha privilegjet që lidhen me atë gradë", tha ajo.

"Nëse Ratko Mladiç do të varroset me nderimet më të larta shtetërore në përputhje me gradën që mbante gjatë konflikteve të armatosura, kjo do të ishte një shkelje e drejtpërdrejtë e ligjit të këtij vendi."

Çfarë duan serbët?

Kur u pyetën se si e shohin Ratko Mladiçin, qytetarët serbë të intervistuar nga DW në disa qytete të krahinës autonome multietnike të Vojvodinës shprehën mendime thellësisht të ndryshme, nga ata që besojnë se Mladiç u dënua padrejtësisht deri tek ata që e pranojnë pa rezerva.

"Çfarë duhej të bënte ai, t'i linte të vrisnin të gjithë serbët? Faleminderit, Mladiç, për gjithçka", tha një burrë nga Ruma për DW.

"Për mua, çështja u mbyll kur u dha vendimi për gjenocid", tha një student nga Novi Sadi.

Por shumica e njerëzve thjesht i shmangen pyetjes.

"Kam mjaft probleme të miat", tha Svetlana nga Zrenjanini.

Gorani nga Novi Sadi beson se kjo është thjesht një çështje tjetër politike. "Na kanë mashtruar prej vitesh. Asgjë nuk ka ndryshuar tani", tha ai për DW.

Lazović beson se shumica e serbëve janë indiferentë ndaj kësaj çështjeje.

Sipas saj, ky është një problem më i madh sesa thjesht fakti që mediat proqeveritare e paraqesin Serbinë si një vend që dëshiron t'i japë lamtumirën Mladiçit si gjeneral. Ajo argumenton se përballja me trashëgiminë e Mladiçit dhe me të kaluarën është thelbësore nëse shoqëria serbe dëshiron të ecë përpara./DW

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[A është vënë në pikëpyetje turneu rajonal i shefes së KE-së për shkak të Serbisë?](#)

17:45 Rajoni

Bedri Hamza: PDK do të veprojë që ligjshmëria të rikthehet në Kosovë

15:55 Rajoni / 1 koment

Pasaporta para njeriut

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.